



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 15.05.2023

Nr: 112

Ora: 12:30

VENDIM

**PËR PUSHIMIN E SHQYRTIMIT TË KËRKESËS NR. 28, DATË 12.05.2023 TË KOMISIONERIT
SHTETËROR TË ZGJEDHJEVE**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 15.05.2023, me pjesëmarrjen e:

| | | | |
|---------|---------|---|---------|
| Elvis | ÇEFA | - | Relator |
| Elvin | LAKO | - | Anëtar |
| Ilirjan | RUSMALI | - | Anëtar |
| Koli | BELE | - | Anëtar |
| Ledio | BRAHO | - | Anëtar |

Shqyrtoi çështjen me:

KËRKUES: Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

OBJEKT: Kërkesë për vendosje sanksioni administrativ, gjobë në masën 5 000 (pesë mijë) lekë ndaj Drejtuesve të Policisë Bashkiake, si më poshtë:

Data: 15.05.2023 Nr: 112
Ora: 12:30



“Për pushimin e shqyrtimit të kërkesës nr.
28, datë 12.05.2023 të Komisionerit
Shtetëror të Zgjedhjeve”

Malësi e Madhe, Pukë, Tropojë, Dibër, Bulqizë, Klos, Mat, Durrës, Krujë, Kamëz, Vorë, Kavajë, Rrogozhinë, Elbasan, Belsh, Peqin, Gramsh, Librazhd, Prrenjas, Berat, Poliçan, Krujë, Pogradec, Maliq, Pustec, Kolonjë, Gjirokastër, Dropull, Përmet, Këlcyrë, Memaliaj, Tepelenë, Selenicë, Himarë, Finiq, Sarandë, Konispol, Lezhë, Mirditë, Fier, Lushnje, Patos, Roskovec, Mallakastër, Skrapar, Fushë Arrëz, Cërrik, Kukës, Delvinë, Has, Libohovë, Vlorë, Kuçovë, Shkodër, Vau Dejës, Devoll, Divjakë.

BAZË LIGJORE:

Neni 19, pika 1, shkronja “c” dhe neni 21, pika 1, shkronja “dh” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Rrethanat e çështjes:

1. Me vendimin nr. 424, datë 03.05.2023 “Për heqjen e materialeve propagandistike që nuk përmbajnë shënimin “Prodhuar nën përgjegjësinë ligjore të ...” (vijon emri i subjektit zgjedhor)”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve (KSHZ) ka vendosur heqjen e materialeve propagandistike që nuk përmbajnë shënimin “Prodhuar nën përgjegjësinë ligjore të ...” (vijon emri i subjektit zgjedhor). Për zbatimin e këtij vendimi janë ngarkuar Policinë Bashkiake dhe Policia e Shtetit, si dhe Drejtuesit e Policisë Bashkiake dhe Policisë së Shtetit, me detyrimin për të raportuar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve lidhur me zbatimin e këtij vendimi, brenda datës 05.05.2023 deri në orën 24:00.
2. Për këtë urdhërim të KSHZ-së, palët janë njoftuar me shkresën nr. 4641 Prot., datë 04.05.2023. Nga informacioni i administruar pranë KQZ-së, rezulton se drejtuesit e Policisë Bashkiake të 57 (pesëdhjetë e shtatë) bashkive nuk kanë raportuar për masat e marra në zbatim të vendimit, në kundërshtim me pikën 4, të vendimit nr. 424/ 2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

3. Mbi këtë bazë, Komisioneri ka vënë në lëvizje KAS-in me anë të kërkesës objekt shqyrtimi, duke kërkuar marrjen e masës administrative me gjobë në masën 5.000 (pesë mijë) lekë ndaj Drejtuesve të Policisë Bashkiakë në 57 bashki.
4. KAS-i caktoi me short z. Elvis Çefa, relator për shqyrtimin e kërkesës nr. 28, datë 12.05.2023 të Komisionerit dhe në seancën paraprake vendosi pranimin për shqyrtim të kërkesës, duke e caktuar seancën e shqyrtimit më 15.05.2023, ora 12:30.
5. Seanca e datës 15.05.2023 u zhvillua me praninë e Sekretarit të Përgjithshëm të KQZ-së, si përfaqësues i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe të specialistëve të administratës së KQZ-së. Drejtuesit e Policive Bashkiake përkatëse, të njoftuar rregullisht, nuk u paraqitën në seancën e shqyrtimit.
6. KAS-i mori në shqyrtim dhe administroi:
 - Kërkesën nr. 28, datë 12.05.2023 të Komisionerit;
 - Vendimin nr. 424, datë 03.05.2023 “Për heqjen e materialeve propagandistike që nuk përmbajnë shënimin “Prodhuar nën përgjegjësinë ligjore të...” (vijon emri i subjektit zgjedhor)”;
 - Vendimin nr. 465, datë 08.05.2023 “Për propozimin e sanksioneve administrative ndaj disa drejtuesve të policive bashkiake, të cilat nuk kanë raportuar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve lidhur me zbatimin e vendimit nr. 424, datë 3.5.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve”;
 - Shkresën nr. 4641 prot., datë 04.05.2023, “Për njoftimin e palëve”.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ dhe të vlerësimit të provave dhe pretendimeve përfundimtare,

KAS-i konstaton se:

1. Kërkesa e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për vendosje sanksioni administrativ konsiston në faktin që 57 (pesëdhjetë e shtatë) drejtuesit e Policive Bashkiake nuk kanë raportuar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për masat e marra nga ata në zbatim të urdhërimeve të Komisionerit me vendimin e tij nr. 424, datë 03.5.2023. Në listën bashkëlidhur kërkesës për

vendosje sanksioni administrativ nuk rezulton të jenë cituar nominalisht emrat e personave kundrejt të cilëve Komisioneri kërkon vendosjen e sanksionit administrativ me gjobë. Lista në fjalë citon vetëm funksionin e subjekteve që kërkohet të sanksionohen si edhe bashkinë përkatëse ku kryhet ky funksion.

2. Nga vlerësimi i dokumentacionit shoqërues të kërkesës së KSHZ rezulton se në procedurën e ndjekur në rastin konkret, Komisioneri ka administruar vetëm dokumentacion shkresor që provon sipas tij faktin që drejtuesit e policive bashkiake në listë, nuk kanë zbatuar urdhërimet e tij. Rezulton se Komisioneri nuk ka zhvilluar një procedurë të plotë hetimi administrativ në të cilën të identifikonte e më pas të thirrte në cilësinë e palës secilin nga individët që mbajnë funksionin e drejtuesve të policive bashkiake të listuara, sikundër parashikohet në nenet 42 e 87 e vijues të Kodit të Procedurave Administrative. Vetëm në këtë mënyrë, palëve u garantohen të drejtat ligjore për të marrë pjesë dhe për t'u dëgjuar në procesin administrativ.
3. Fakti që individët që mbajnë funksionin e drejtuesve të policive bashkiake të listuara, ndaj të cilëve propozohet sanksionimi me gjobë, nuk kanë pasur dijeni për zhvillimin e hetimit administrativ nga KSHZ, përbën një pengesë ligjore serioze për vijimin e mëtejshëm të procedimit administrativ nga KAS për shqyrtimin e kërkesës së Komisionerit, në kuptim të zhvillimit të një procesi të rregullt ligjor.
4. Lidhur me sa më sipër, Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së gjatë seancës së shqyrtimit në KAS kërkoi tërheqjen e kërkesës nr. 28, datë 12.05.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve me qëllim plotësimin e saj në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative. Nisur nga këto rrethana, bazuar në pikën 1 të nenit 95 të Kodit të Procedurave Administrative tërheqja e kërkesës passjell detyrimin e KAS për deklarimin e përfundimit të procedurës pa një vendim përfundimtar për çështjen, pra pushimin e shqyrtimit të kërkesës.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 21, pika 1, shkronja “dh” dhe në nenin 143, pika 1, shkronja “a” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve,

V E N D O S I:

1. Pushimin e shqyrtimit të kërkesës nr. 28, datë 12.05.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.
2. Ngarkohet administrata e KQZ-së me njoftimin e këtij vendimi palëve në mungesë dhe me zbatimin e tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Bazuar në pikën 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga njoftimi i këtij vendimi.

U shpall sot më datë 15.05.2023.

| | | | |
|----------------|----------------|---|----------------|
| Elvis | ÇEFA | - | Relator |
| Elvin | LAKO | - | Anëtar |
| Ilirjan | RUSMALI | - | Anëtar |
| Koli | BELE | - | Anëtar |
| Ledio | BRAHO | - | Anëtar |